



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE FIER
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Fier, më ____ .06.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“Blerje çakëll”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

“Çakëll” 14212310-6.

VLERA E FONDIT LIMIT: 14 931 000 *(katërmëdhjetë milion e nëntëqind e tridhjetë e një mijë)*
lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të Ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik“, i ndryshuar, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”*

b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1, Neni 83: *“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.”*

Pika 2 Neni 83: *“Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës”, si dhe në nenin 30 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit (**2023, 2024**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091, datë 5.3.2009, *“Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”*, i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabël.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në bilanci e kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *”4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilanci, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilanci/en e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit¹.”* Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në ligjin nr.25/2018, “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetin ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2023, 2024**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se **13 000 000 lekë pa TVSH** (vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *”3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti*

që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; në pikën 1 dhe pikën 2/b të nenit 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/b e nenit 43 të VKM nr. 28,5 datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohej në Procedurën e Hapur, përkatësisht; Pika 2/b: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;* Duke qënë se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit mbi kufirin e lartë monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë gjykon se është e përshtatshme vendosja e kriterit të marzheve mesatare të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik, për të mundësuar pjesëmarrje më të gjerë të operatorëve ekonomikë të interesuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;**”, si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale

vjetore e të ardhurave; Njësia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e 2 (dy) viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të kontratës që prokurohet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **5 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- i.** Vërtetime të lëshuara nga enti publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës; **dhe,**
- ii.** Faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatori ekonomik të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **5 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së

përllogaritur të kontratës që prokurohet) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë :

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe piken 4 të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet përvojës së mëparshme, se zoterojnë kapacitet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar dhe argumentuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të 251/1 prot., datë 20.03.2025, të Drejtorit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike në procesverbalin e grupit të punës me nr.251/9 prot., datë 27.03.2025 dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, si dhe në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.

Specifikimet teknike gjenden bashkëngjitur DST në SPE.

Njësia e Prokurimit: